



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.01.2019 ora 12.00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i kërkesës së kryetarit të komisionit hetimor, z. Edi Paloka, për zgjatjen e afatit të veprimtarisë të komisionit hetimor, ngritur me vendimin nr. 30.2018 "Për të kontrolluar ligjshmërinë e veprimeve administrative të organeve të pushtetit legjislativ apo ekzekutiv në kultivimin dhe trafikun e lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën akuzohet ish ministri i Brendshëm z. S. Tahiri", dhe zgjatur afati më 6 shtator 2018 me vendimin nr. 93/2018.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Vasilika Hysi -	Nënkryetare e Kuvendit
Edi Paloka -	Nënkryetar i Kuvendit
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Edmond Spaho -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike
Fatmir Mediu -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Republikane
Genc Pollo -	Kryetar i Komisionit për Integrimin European
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare
Albana Vokshi -	Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Mimi Kodheli -	Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave
Ulsi Manja -	Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Mungojnë:

Petrit Vasili -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim
	Kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

HAPET MBLEHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, të cilën e kam thirrur për të shqyrtuar kërkesën e kryetarit të komisionit hetimor “Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton zotin Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm”. Siç ju ka vënë në dijeni edhe vetë zoti Paloka, në mbledhjen e kaluar, në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni, ka paraqitur kërkesën për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor.

Zoti Paloka.

Edi Paloka – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, dua të ngre shqetësimin, të cilin e ngrita edhe në Konferencën e kaluar, që lidhet me dështimin e deritanishëm të punës së komisionit, për të cilën mban tërësisht përgjegjësi qeveria për mosreagimin e saj, megjithëse ka detyrimet ligjore dhe kushtetuese t’i përgjigjet çdo kërkesë të komisionit hetimor.

Ju thashë edhe herën e kaluar që dy institucionet kryesore, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë që lidhen direkt me këtë hetim, por jo vetëm ato, unë kam theksuar këto dy institucione për shkak se kanë edhe rëndësinë më të madhe për komisionin hetimor, por edhe Kryeministria, edhe Ministria e Mbrojtjes, edhe Ministria e Drejtësisë, edhe Drejtoria e Doganave, të gjitha bashkë kanë nxjerrë fillimisht një justifikim: kanë kërkuar më tepër kohë për të kthyer përgjigje, afate, të cilat ishin absurde dhe unë i kam të gjitha këtu me radhë... Për shembull, Ministria e Brendshme ka kërkuar: “Nga një vlerësim paraprak konstatohet se për të gjetur, për të mbledhur dhe për të përpunuar të gjithë materialin, sipas kërkesave tuaja, për këtë informacion duhen 50-60 ditë”. Bëhet fjalë për përgjigjen e dhënë më 12 prill të vitit 2018. Edhe Ministria e Drejtësisë kërkon shtyrje afati, pa përcaktuar se sa i duhet. Drejtoria e Policisë e ka edhe më interesante përgjigjen: “Shtyhet afati i përgjigjes deri në datën 30.04.2018”. Kjo është kërkesa: të shtyhet deri më 12.04.2018, për arsye se kërkohet volum i madh. Gjithashtu, thotë: “Në këto momente Policia e Shtetit, siç jeni në dijeni, është e angazhuar në procesin e plotësimit të dokumentacionit për vetingun”. Pra, Policia e Shtetit, kur u mor me vetingun, nuk u mor me asnjë punë tjetër.

Afatet e ekzagjeruara që kërkuar për të kthyer përgjigje, kanë kaluar disa herë dhe më 5 shtator mbaroi afati i parë i komisionit, më 6 shtator miratuam shtyrjen e parë të këtij komisioni, por nuk ndryshoi asgjë tjetër, përveç afatit. U ndryshuan edhe ministrat, edhe drejtuesit e institucioneve, por nuk ndryshoi reagimi ndaj komisionit hetimor.

Për të gjithë ne është më se qartë pse ndodh kjo. Absolutisht, ne po hetojmë lidhjet e kësaj qeverie me krimin dhe me trafikun e drogës. Saimir Tahiri është vënë në qendër të këtij hetimi, sepse ka qenë ministër i Brendshëm, por, sigurisht, fijet janë të lidhura nga Kryeministri deri poshtë. Kjo është e vetmja arsye pse edhe përgjigjet kanë ardhur, sepse ju ka humbur edhe fantazia tani, gati shabllon, me të njëjtën formulë, që jua ka çuar dikush nga lart dhe kanë vetëm një qëllim: të pengohet hetimi, në shkelje të Kushtetutës, në shkelje të ligjit, por edhe në shkelje të Kodit Penal.

Për të gjitha këto arsye, unë, në radhë të parë, kam kërkuar që ju t'i jepni dinjitetin e duhur parlamentit dhe t'u kërkonit llogari këtyre institucioneve, sepse nuk kemi të bëjmë thjesht me injorimin e parlamentit, por me shkelje të Kushtetutës dhe ligjit. Opozita, të vetmet mundësi që ka për të kontrolluar qeverinë janë instrumentet që i jep parlamenti nëpërmjet komisioneve hetimore apo formave të tjera. Në qoftë se këto instrumente bllokohen, duke filluar që këtu... Në fakt, i dimë historitë e komisioneve, që fillojnë njëherë me ndryshimin e objektit të hetimit, kjo është bërë tashmë histori bajate, pra ne kërkojmë diçka, ju na ndërroni objektin e hetimit, megjithatë ne pranuar për hir të vazhdimit të procesit të hetimit, pastaj vijnë të gjitha këto bllokimet e tjera, të urdhëruara në të njëjtën formë nga të gjitha institucionet, të cilave u është kërkuar të mbajnë përgjegjësi.

Është edhe një justifikim i tejkaluar disa herë: disa prej institucioneve përmendim dokumentacionin sekret, por, siç e dimë, të gjitha aspektet procedurale dhe ligjore, që lidhen me marrjen dhe me shfrytëzimin e informacionit sekret, janë kaluar. Anëtarët e komisionit u pajisën me certifikata sigurie; në ambientet e parlamentit u krijuan kushtet për marrjen e këtij dokumentacioni dhe gjithçka tjetër është konform ligjit dhe precedentëve. Vetë ky parlament ka hetuar Shërbimin Sekret, kur ishte Fatos Nano Kryeministër. Unë kam qenë anëtar i atij komisioni, ku kemi hetuar dhe kemi parë çdo dokument që kemi dashur në Shërbimin Sekret. Tani del një nga doganat dhe thotë: “Kam unë dokumente sekrete, a jeni ju të pajisur me certifikata?”! Drejtorja e Doganave, përpara se të na çojë dokumentacionin, na kërkon llogari neve nëse kemi certifikata sigurie!

Pra, pa e zgjatur, edhe një herë për ne është e qartë gjithçka: kjo bëhet për të penguar hetimin, sepse të gjitha kokat e kësaj qeverie kanë qenë të implikuara. Duke filluar nga Kryeministri, ministri i Brendshëm, familjarët e ministrave të Brendshëm, duke përfshirë edhe Xhafajn, të gjithë kanë qenë të implikuar në trafikun e drogës, dhe kjo është arsyeja e vetme pse pengohet ky hetim.

Në këto kushte, unë kërkoj edhe një herë shtyrjen e afatit, sigurisht, kërkesa e parë ju drejtohet juve që t'u kërkonit këtyre institucioneve, të cilat sot janë me ministra të rinj, por me

asgjë tjetër të re përveç fytyrave, të zbatojnë ligjin dhe Kushtetutën. Është edhe detyrimi juaj t'u kërkon të zbatojnë ligjin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë besoj se shërbimet e Kuvendit duhet t'ua kenë vënë tashmë në dispozicion të gjithë ecurinë e këtij komisioni hetimor, për të cilin kërkohet zgjatja e afatit nga opozita, por për kolegët, njëkohësisht edhe për ata që marrin pjesë në këtë mbledhje, dua të bëj me dije se ky komision u vendos të ngrihej që në mars të vitit të kaluar dhe që nga marsi i vitit të kaluar, në fakt, janë zhvilluar vetëm katër mbledhje, nga të cilat tre i ka thirrur zoti Paloka dhe një e ka thirrur maxhoranca. Siç kuptohet, tri mbledhjet e para kanë qenë të natyrës formale, pra konstituimi i komisionit, zgjedhja e sekretarit të komisionit, mandej kemi bërë edhe caktimin e ekspertit dhe kjo ka qenë mbledhja e fundit.

Gjatë rrugës komisioni ka pasur probleme, sepse zoti Paloka dhe opozita kanë penguar që komisioni hetimor, maxhoranca përkatësisht të adresonte kërkesat e saj, duke mbajtur qëndrimin që komisionet hetimore që ngrihen, kushdo qoftë ai që i kërkon, janë pronë ekskluzive e atij që i kërkon, por nuk është kështu, sepse në komisione marrin pjesë, edhe maxhoranca edhe opozita. Ligji për komisionet hetimore e saktëson qartësisht, pa lënë asnjë dyshim, që të gjithë anëtarët kanë të drejtë të bëjnë kërkesat e tyre, por përtej kësaj, të gjitha shkresave që u janë drejtuar institucioneve, ku po u referohem vetëm shkresave që ka bërë opozita, u është kthyer përgjigje, sepse ka kthyer përgjigje SHISH-i, kryeministria, presidenca, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Prokuroia e Përgjithshme, Gjykata e Rrethit Tiranë, IEVP “Jordan Misja”, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Doganave, Ministria e Mbrojtjes, QKB-ja, Ministria e Bujqësisë e të tjera me radhë. Të gjitha shkresat janë aty, qoftë shkresat dalëse nga institucioni, qoftë shkresat hyrëse. Ju thoni që këtë hetim e ka penguar fakti se nuk kanë ardhur përgjigjet që ju keni kërkuar nga Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë, të cilat, në fakt, edhe në detyrim të asaj që kërkohet, por edhe në respekt të institucionit, kanë kthyer përgjigje dhe kanë kërkuar kohë për vetë volumnin e dokumentacionit që kërkohet. Në qoftë se e marrim të mirëqenë pretendimin tuaj që ju penguan institucionet të hetoni, po ju çfarë ju pengoi të bënit kërkesën për zgjatjen e afatit të komisionit hetimor në kohën kur duhej bërë kjo kërkesë? Ky komision e kishte mbaruar afatin e veprimit, mandatin që ishte dhënë nga Kuvendi në shtator të vitit 2018, ku u kërkuar zgjatja nga ju dhe Kuvendi e miratoi zgjatjen deri në fillim të dhjetorit, por nga dhjetori deri më 20 janar, kur ne filluam këtë sesion parlamentar, nuk ka pasur asnjë kërkesë nga ju që ky komision hetimor të mund të

vazhdonte aktivitetin e vet dhe ju të arsyetonit para Konferencës së Kryetarëve, por edhe të Kuvendit të Shqipërisë pse e kërkonit zgjatjen e afatit. Ndërkohë, u zgjat afati një herë dhe zoti Paloka ka që nga muaji prill që nuk e ka mbledhur komisionin, qoftë edhe për të komunikuar zgjatjen dhe për t'u bërë me dije të gjithë anëtarëve të komisionit se çfarë ka ardhur dhe çfarë nuk ka ardhur dhe, natyrisht, për të përdorur të gjitha të drejtat që ia njeh Rregullorja e Kuvendit, si kryetar i atij komisioni t'u drejtohet institucioneve për kërkesat e tij. Pra, i gjithë rrugëtimi që ka ndjekur veprimi i këtij komisioni hetimor tregon qartësisht se ju nuk keni pasur interes dhe e keni humbur interesin për këtë komision hetimor. Në fakt, ju nuk keni pasur interes që nga dita e parë që ngritët këtë komision, por e përdorët për propagandë, doni ta përdorni për propagandë dhe, meqenëse keni vendosur të bëni një protestë, doni të ushqeni arsytet publike të kësaj proteste dhe të përdorni këtë gjë. Por, sipas mendimit tim personal, Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të përdoret në këtë mënyrë, sepse kështu jo vetëm që krijohet një precedent i parë... Unë kam parë të gjithë praktikën parlamentare që nga viti 2013, por edhe para vitit 2013, ku kërkesat për ngritje komisionesh hetimore, në mënyrë qesharake, më shumë i keni bërë ju që ishit në maxhorancë sesa ne që ishim në opozitë, dhe nuk ka një rast të vetëm kur kërkesa për zgjatjen e afatit të jetë bërë ndërkohë që afatet kishin kaluar. Komisionet hetimore nuk veprojnë ashtu sikundër ua merr mendja atyre që drejtojnë apo përbëjnë komisionin hetimor, por është Kushtetuta, është ligji për komisionet hetimore dhe është Kodi i Procedurës Penale, të cilët rregullojnë veprimtarinë e komisioneve hetimore. Në asnjë vend, në këto tri ligje që përmenda, nuk mund të gjejmë një logjikë të tillë, që afati i veprimtarisë të një komisioni apo hetimi ka mbaruar dhe hajde të kujtohem të kërkojmë afat. Në këtë mënyrë do të humbiste kuptimin edhe vetë vendimmarrja e Kuvendit. Për çfarë do të mbledhet Kuvendi i Shqipërisë dhe të vendosë për ngritjen e një komisioni hetimor, të vendos për zgjatjen e një afati të një komisioni hetimor, kur vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nuk respektohen? Nuk do të kishte asnjë kuptim as kjo mbledhje, as vendimet që do të merrnin dhe as vendimet që do të marrim më tej. Unë besoj se jemi treguar shumë tolerantë, sepse nuk është e vërtetë që komisionet hetimore do të ngrihen me çfarëdolloj objekti, pasi Kuvendi i Shqipërisë ka një detyrë, që është detyra të kontrollojë që objekti të jetë kushtetues, por, përtej kësaj, mirë që objekti është ky që është dhe nuk po bëj më shumë komente, por të mos jemi seriozë as me afatin dhe të mos vijmë në Kuvendin e Shqipërisë për kërkesa që vetë i drejtojmë, të mos tregojmë minimumin e interesit për funksionimin e një komisioni dhe të kujtohem kur kemi axhendat tona dhe ta vëmë Kuvendin në lëvizje, kjo nuk është aspak logjike dhe nuk tregon respekt për institucionin e Kuvendit të Shqipërisë.

Më falni, zoti Kryetar, nëse u zgjata, por realisht kjo ka qenë situata e këtij komisioni, që opozita nuk ka interes të kryejë në vetvete ndonjë hetim, por thjesht kërkon të krijojë tensione artificiale, thua se çfarë po ndodh në Shqipëri, dhe ka një arsye kaq të madhe publike, sa të organizojnë edhe protesta mbarë popullore. Ju që talleni, e tregoni hapur me këtë kërkesë që keni bërë sot.

Edi Paloka – Për të përgënjeshtuar ato që tha zonja nënkryetare e komisionit, dua t’ju them se ju e njihni shumë mirë edhe ligjin, edhe procedurën e komisioneve hetimore, megjithatë, unë po jua lexoj, nëse nuk e keni rifreskuar së fundi, nenin 15 të ligjit për komisionet hetimore, “Fillimi i hetimit”, pika 1 thotë: “ Pas njohjes me objektin e çështjes që do të hetohet, komisioni mbledh të dhëna për çështjen. Të dhënat mund të jenë informacione zyrtare dhe jozyrtare, por që njihen publikisht”. Pika 2 e nenit thotë: “Komisioni merr të dhëna nga burime të drejtpërdrejta”. Në pikën 3 thuhet: “Pasi sigurohen të dhënat paraprake për çështjen, komisioni me vendim të ndërmjetëm miraton planin e hetimeve deri në përfundimin e tyre....”, nuk po vazhdoj më tej. Në pikën 5 thuhet: “Pas miratimit të planit të hetimit, komisioni deklaron fillimin e hetimeve”. Si mund t’ju mblidhja unë ju, kur ne nuk na kanë ardhur informacionet, zonja nënkryetare?! Si do ta bënim planin e hetimit, kur ne nuk kishim asnjë informacion nga institucionet tuaja?! Jua tregova përgjigjet, ku njëri thotë që po merrem me vetingun, tjetri, Fatmir Xhafaj, na tregonte sesi duhet të funksionojë komisioni, një tjetër kërkonte 60 ditë dhe në fund fare Shërbimi Informativ ka sjellë informacione, ka edhe 2-3 informacione të parëndësishme të institucioneve të tjera, por që as Ministria e Brendshme dhe as Drejtoria e Policisë, të cilat janë kryesoret, nuk kanë sjellë as edhe një rresht informacion. Atëherë, si do ta bënim ne planin e hetimit? Si do të funksiononte komisioni, të mblidheshim dhe të shiheshim bashkë dhe të pinim kafe me njëri-tjetrin?! Unë kafet, zakonisht, i pi me miqtë e mi dhe nuk vij të pi kafe me maxhorancën. Komisioni nuk ka pasur asnjë mundësi të hedhë qoftë edhe një hap më tej nga ato ku kemi arritur. Ne kemi pritur informacionet, ju është bërë e ditur juve, si anëtarë të komisionit, dhe është bërë e ditur publikisht, kur kemi kërkuar shtyrjen e afatit herën e parë dhe po e rithemi prapë. Sigurisht, komisioni dështon dhe ngelet aty ku është në qoftë se institucionet nuk përgjigjen. Unë këtë po kërkoj në radhë të parë nga Kryetari i parlamentit, nga ju si maxhorancë, megjithëse thashë se jam i bindur që do të gjeni lloj-lloj justifikimesh për ta penguar prapë komisionin....Dëgjova edhe justifikimin që qenkemi ne fajtorë dhe se ju nuk jeni të shqetësuar për këta që shkelin Kushtetutën dhe ligjin, duke mos iu përgjigjur komisionit hetimor, por qenkeni të shqetësuar se paskan kaluar disa ditë nga afati që ne duhet të bënim kërkesën. Kjo qenka e rëndësishmja. Këta që shkelin Kushtetutën dhe

fshehin informacionet ndaj një komisioni hetimor, këta janë në rregull dhe nuk kemi probleme, por problemi është opozita, që nuk e bëri dot kërkesën disa orë më parë.

Taulant Balla –Kuvendi i Shqipërisë ka krijuar tashmë një traditë të konsoliduar në komisionet hetimore, pavarësisht se pjesa e tyre më e madhe nuk e kanë realizuar besimin që u ka dhënë Kuvendi për të përfunduar mandatin dhe përgjegjësinë që kanë marrë dhe për të konkluduar me një raport. Janë të rralla komisionet që kanë konkluduar me raport. Për fat të keq, në 4 vjetët e shkuar dhe në këtë vit komisionet e drejtuara nga opozita, për shkak të të drejtës së sanksionuar me ligjin e komisioneve hetimore, nuk e kanë përfunduar mandatin e tyre. Unë, si anëtar i kësaj Konference Kryetarësh, u interesova pranë sekretarisë për të marrë vesh se kur i ka mbaruar mandati këtij komisioni. Kanë kaluar pothuajse dy muaj nga përfundimi i mandatit të këtij komisioni.

Shtyrja e fundit është votuar vetëm, e mbani mend, nga maxhoranca, sepse ju nuk ishit fare. Ne votuam për ta shtyrë, pasi besojmë se opozita një ndër instrumentet që ka për ta ushtruar rolin e saj monitorues, si *watchdog* parlamentar, ka pikërisht komisionet hetimore.

Unë kam drejtuar komisione hetimore, madje mund të jem deputeti që ka marrë pjesë në më shumë komisione hetimore në të gjithë historinë e vetë komisioneve hetimore, por nuk mund ta lidhësh kurrë veprimtarinë e punës së komisioneve parlamentare hetimore me një pjesë, siç u raportua, të vogël dokumentacionesh ende të pambërritura.

Unë kam qenë edhe në komision hetimor parlamentar për rrugën Durrës-Kukës, një komision, i cili as që kishte nevojë për certifikatë sigurie për informacionin e klasifikuar dhe të cilit, me vendim politik, nuk iu dha asnjë letër. Këtij komisioni hetimor nuk do t'i jepet asnjë shkresë; vendim politik. Dakord, e tillë ishte koha. “*Rising star*-i” nuk duhej dëmtuar, por këtu nuk bëhet fjalë për...

Kush thotë: “Ç’punë ka Dogana të kërkojë certifikatë sigurie”, t’i referohet ligjit “Për administrimin e dokumentacionit të klasifikuar në Republikën e Shqipërisë”. Sigurisht, rasti në fjalë ka përfshirë dhe ka bërë të domosdoshëm respektimin e të gjithë kuadrit të informacionit të klasifikuar.

Unë e shqyrtova dhe e shoh me kujdes kërkesën.

Ju lutem, por ju paskeni nevojë për të ngritur një komision hetimor tjetër me këtë kërkesë që keni sot, këtu bëhet fjalë për shkelje të rënda të Kushtetutës, fajtorët qenkan identifikuar për shkelje të tjera.

Zoti Pollo ka drejtuar një komision mandatin e shkuar, i cili kaloi në *state note*-in e mandatit të tij. Kuvendi i Shqipërisë ka praktikë të konsoliduar tashmë që për çdo lloj komisioni, qoftë ati edhe zgjedhor, në rast se i ka mbaruar mandati, komisioni quhet i

përfunduar. Por në asnjë rast, nga ana jonë, nuk do t'ju hiqet e drejta, përkundrazi, do t'ju mbështesim gjithmonë, sa herë të sillni kërkesa, për komisione hetimore, sepse ne nuk do të bëjmë kurrë ato që na keni bërë ju, kur keni qenë ju në maxhorancë dhe ne në opozitë.

Për të konkluduar dhe për të qenë më i qartë, që nesër sillni kërkesë për ngritjen e një komisioni hetimor po për këtë çështje, por, kurrësi, ishit në gjumë, nuk ishit në gjumë; kishit harruar, nuk kishit harruar; dy muaj, pasi i kishte mbaruar mandati komisionit, që, në mos gaboj, ka qenë data 8 dhjetor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...6 dhjetor ka mbaruar mandati i komisionit, ndërkohë ju vini më 15 janar, kur është depozituar kërkesa, për të kërkuar shtyrje. Kjo minimalisht nuk ju bën mirë në publik, se mund të harrojë tjetri një ditë, dy ditë, por jo të harrojë me muaj, me vite.

Paskemi harruar ne dhe paska kaluar?! Sigurisht që po, sepse Rregullorja është libri i rregullave. Ishim poshtë në Komisionin e Ligjeve pikërisht për të përditësuar Rregulloren e Kuvendit, që edhe të kujtohen ata që bëjnë kërkesa.

E dyta, që të mos e marr më fjalën, në seancën plenare të ditës së nesërme, ne do të ngremë një komision tjetër hetimor parlamentar me kërkesën e opozitës.

Do të uroja që ai komision, që do të ngrihet nesër, më në fund të dalë me një raport, se, sigurisht, i bën mirë edhe jetës sonë parlamentare.

Faleminderit!

Edmond Spaho – Zoti Kryetar, i dëgjova me kujdes të dy folësit nga maxhoranca dhe, me thënë të drejtën, mënyra se si flasin nuk mund të cilësohet veçse si cinike, për të mos thënë tallje, pa u skuqur fare as njëri, as tjetri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...dhe pa iu referuar në asnjë rast asnjë norme ligjore.

Këtu thelbi i problemit është që institucionet nuk dërgojnë informacion.

A mund të më paraqisni ju, qoftë edhe një fije letër, informacion, një dokument të vetëm, që ka ardhur që nga krijimi i këtij komisioni, në fillim të vitit 2018 deri sot? Meqenëse fajin e ka opozita, po të paraqisni qoftë edhe vetëm një fije letër, që përbën informacion të kërkuar nga komisioni, jam dakord, pastaj tërhiqemi.

Së dyti, ne e kemi shtyrë një herë afatin e këtij komisioni. Pse e shtymë afatin? A mund t'i shikoni procesverbalet dhe kërkesën tonë? Për këtë arsye, sepse institucionet nuk sjellin informacion.

Ju keni qenë këtu, në Konferencën e Kryetarëve? E dini sa herë është ngritur çështja se institucionet nuk sjellin informacion, madje çështja i është ngritur zëvendëskryeministres dhe i është dhënë porosi ta ndjekë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu ju nuk duhet të na akuzoni neve, por ne duhet t'ju pyesim juve: a mund të na tregoni një letër të një veprimi që ka bërë Kryetari i Kuvendit për të garantuar marrjen e informacionit? Sepse mbaroi afati i parë, mbaroi edhe afati i dytë dhe mbetet e njëjta çështje. Pra, a mund të na tregoni ju sa seriozë keni qenë në garantimin e informacionit për komisionin?

A mund të më tregoni një letër, që e ka dërguar zëvendëskryeministria tek institucionet e vartësisë së saj, për t'i detyruar, sipas ligjit dhe Kushtetutës, që të na sjellin informacion? Se, fundja, pse e shtytë afatin ju, pse e votuat? Për këtë punë e votuat, sepse kishte argumente, që e mbështesnin kërkesën tonë, që ju nuk po sillni informacion, që nuk doni të jepni informacion! Kështu që këtu duhet të tregohemi seriozë. Ndërkohë, rrimë e merremi: jo e bëtë kërkesën në janar, jo e bëtë në dhjetor. Këtë çështje e kemi ngritur edhe në muajin dhjetor, por çështja këtu nuk është nëse duhet ngritur komision i ri apo duhet shtyrë afati, kjo është ana formale, këtu flitet nëse ky komision do të punojë ose jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Genc Pollo – Në fakt, unë doja të ngrija një çështje tjetër, jashtë rendit të ditës, në qoftë se më lejoni pasi të mbarojmë me këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por për këtë çështje dua të flas...

E dëgjova që u citua edhe një komision hetimor, të cilin e kam kryesuar unë, ndërsa zoti Manja ka qenë nënkryetar. Ne, në mënyrë të përsëritur, u jemi drejtuar dy ose tri institucioneve, varet se si e llogarit, ministrit të Brendshëm, asokohe “star” i rëndësishëm i partisë kryesore në pushtet, ministrit të Drejtësisë, partia e të cilit sot është në opozitë, dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Kemi marrë informacion, në dukje të mjaftueshëm, domethënë vandak me letra, por krejt të papërdorshëm për qëllimet për të cilat ishte ngritur komisioni. Me gjithë kërkesat e përsëritura për të verifikuar databazat e tyre në raport me kërkesat tona (ishte, jua kujtoj, komision specifik për të gjetur në administratë, në organet e sigurisë me prioritet, persona me të kaluar penale, edhe këta “star” në rritje ose jo, të vegjël të partisë së “stars-ave”, të partisë kryesore në pushtet) dhe në mënyrë të vazhdueshme nuk kemi marrë informacion dhe si përfundim komisioni u shua pa një raport, kjo është e vërtetë, por nuk kishim si të ngrinim një raport.

Në qoftë se këto dy raporte maxhorancë – opozitë, siç është bërë shpeshherë, në mungesë të informacionit zyrtar. Mosparaqitja e këtij informacioni në bazë të legjislacionit për komisionet hetimore dhe të Kodit Penal, është një vepër penale.

Ne po debatojmë se si do të jetë drejtësia e re dhe si do të funksionojë. Nuk e di a do të jetë prioritet kjo që po them unë, por mosveprimi nga ana e titullarëve në mënyrë të qëllimshme (këtë e supozoj), të përsëritur dhe të faktuar me dokumente, është diçka që duhet ndjekur në mënyrë që të mos kemi as sot, as nesër një papërgjegjshmëri apo një mungesë vullneti për zbatimin e ligjit dhe për ta ndihmuar Kuvendin për të ushtruar funksionin e tij kontrollues, monitorues. Kjo ka qenë historia e komisionit tim dhe në këtë kontekst futet edhe përvoja ime në debatin e sotëm. Në fund, ndoshta mund të them edhe ndonjë gjë tjetër.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Kam një pyetje për stafin: Moza, a kemi pasur precedentë kur ka mbaruar afati dhe kërkesa është bërë jashtë afatit? Si është vepruar nga Kuvendi?

Mimoza Pano – Në legjislaturën e kaluar kemi pasur 2 raste, kur ka përfunduar afati i veprimtarisë së komisionit hetimor dhe kërkesa është bërë jashtë afatit. Pas diskutimeve në Konferencën e Kryetarëve, është dakordësuar nga kryetarët e grupeve parlamentare, që komisioni të ringrihet nga e para. Pra, Kuvendi ka votuar një vendim për ngritjen e komisionit hetimor me të njëjtin objekt.

Gramoz Ruçi – E qartë.

Atëherë, në qoftë se nuk ka ndonjë gjë të re, për ta mbyllur, unë kam për të thënë 3-4 gjëra, duke marrë shkas nga ky debat që po zhvillojmë.

E para, nuk duhet të kemi ndarje pozitë – opozitë, sepse më tërhoqi çështja e dinjitetit të Kuvendit dhe detyrimi i Kryetarit. Duhet të kuptojmë se nuk ka asnjë kompetencë Kryetari për ta rritur dinjitetin e Kuvendit. Ai ka një numër, një zë, një votë. Prandaj, unë do të thosha që duhet të jemi bashkë për një problem: e vërteta është se që t'i rritet dinjiteti Kuvendit, kontrolli parlamentar i Kuvendit tonë duhet forcuar. Pikë. Këtu nuk duhet të fshihen as pozita, as opozita. Kjo do të thotë, nëse një deputet individualisht, meqë kemi edhe zonjën Spiropali, ministren e re për Marrëdhëniet me Parlamentin, së cilës i urojmë suksese, qoftë edhe një deputet, jo më një komision apo një grup parlamentar, ka një kërkesë të cilido institucion i ekzekutivit për një informacion të caktuar, këtu nuk duhet të ketë asnjë neglizhencë. Ky është dinjiteti i parlamentit.

Kur themi dinjiteti i parlamentit, të mos harrojmë se ne jemi një republikë parlamentare dhe kur e themi këtë, atëherë je i detyruar me Kushtetutë t'i përgjigjesh deputetit

individualisht, brenda afatit përkatës, si dhe komisioneve të parlamentit qofshin ato të përhershme, apo jo.

Ja ku jemi sot në Konferencën e Kryetarëve, për ta çuar dinjitetin tonë si parlamentarë dhe si Kuvend në tërësi. Mjetet, instrumentet që ka parlamenti për të ushtruar këtë kontroll janë: kërkesa e informacioneve, seancat e pyetjeve, numri i të cilave lë për të dëshiruar (një gjithsej në sesionin e kaluar); janë seancat e interpelancave (në mos gaboj, dy kanë qenë në sesionin e kaluar); janë edhe mocionet me debat, që nuk bëhen.

Ne në çdo seancë zhvillojmë debate, por asnjëherë nuk jemi fokusuar për një problem të caktuar, me një ministër të caktuar, me Kryeministrin, apo me çdo institucion tjetër, që varet nga Kuvendi. Kaluam mbi 20 institucione të ngritura me Kushtetutë dhe nuk pati asnjë kërkesë për të zhvilluar debat me asnjë institucion (përfshijë debatin që zhvilluam në komisione).

Prandaj, këtu nuk ka nevojë, të gjithë jemi të ndarë sipas alternativave, programeve dhe subjekteve që na kanë sjellë në parlament, por lidhur me dinjitetin e parlamentit, ne duhet ta forcojmë kontrollin parlamentar dhe kjo, sipas mendimit tim, nuk duhet të ketë ndarje midis krahësh. Kjo në vetvete është rritje e dinjitetit të parlamentit dhe e deputetit në vetvete.

E dyta, është çështja; pse ka ardhur në këtë derexhe që komisioni ka 9 muaj që është ngritur dhe nuk e ka dhënë produktin? Komisioni është ngritur në mars, pra ka 9-10 apo 12 muaj. Janë dy çështje dhe ne nuk duhet të fshihemi pas tyre. E para, është mosplotësimi i kërkesave të komisionit nga dy dikastere të ekzekutivit, të cilat kanë kërkuar 1 muaj kohë.

Maxhoranca do të kishte plotësisht të drejtë, nëse me kërkesën që ka bërë ministri i Brendshëm dhe Drejtoria e Policisë, pas një muaji këto dokumente do të ishin në tryezën e komisionit hetimor. Edhe sot e kësaj dite ato dokumente nuk janë. Fakti që nuk janë, tregon që ata nuk e kanë plotësuar detyrën në raport me parlamentin. Informacioni i kërkuar duhet të vijë dhe të depozitohet në Kuvend. Ka kërkuar 1 muaj afat? Po. Ja ku jemi edhe pas 7 muajsh dhe ato dokumente nuk janë në Kuvend.

E treta, nuk duhet të fshihemi pas gishtit. Ka dy probleme, një për maxhorancën dhe një për opozitën, e cila nga shtatori, kur i është shtuar afati dhe deri në fund të dhjetorit, ka qenë në marrëdhënie të kushtëzuar dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë komision të parlamentit (as komisione hetimore, as në komisionet e përhershme), as në seancat parlamentare, vetëm me ndonjë rast të veçantë.

Sigurisht, ajo është sovranë në qëndrimet e saj. Unë nuk jam këtu për të diskutuar nëse ka bërë mirë apo ka bërë keq. Këto janë mjete që përdoren nga çdo subjekt politik. I kam

përdorur edhe unë, kur kam qenë në opozitë. Ky është shkaku i dytë (nuk është realizuar kërkesa).

Mund t'i themi se përse nuk e ke kërkuar në datën 4 apo në datën 6, kur i takonte afati i fundit, kryetarit të tij, zotit Paloka, por ai ka ardhur në parlament në datën 18. Ai kishte një qëndrim politik, të cilin ne nuk mund ta diskutojmë, nëse ishte i mirë apo i keq. Për këtë veprim është sovran subjekti politik, që ai përfaqëson.

Pse themi se opozita ka përgjegjësi? Shpesh ne nuk i interpretojmë gjërat ashtu siç duhet. Vërtet kërkesën e ka bërë opozita, vërtet drejtimin e komisionit e ka bërë opozita, por maxhorancën e komisionit e ka maxhoranca. Është mungesë përgjegjësie, zonja zëvendëskryetare, së bashku me anëtarët e komisionit, që në mbarim të afatit të komisionit, të jepje ose produktin (raportin, siç e mendon ti), ose kërkesën për të shtuar afatin. Komisionin vërtet e ka kërkuar dhe e drejton opozita, por maxhorancën e ke ti, ta ka dhënë ty ligji dhe ti nuk e ke mbledhur komisionin që ta quaje të përfunduar punën e tij apo të kërkoje rritjen e afatit të komisionit, meqë dokumentet nuk kanë ardhur dhe meqë opozita që e ka kërkuar, ka pasur një qëndrim të caktuar ndaj parlamentit. Kështu duhet t'i gjykojmë gjërat dhe jo ta hedhim fajin te njëri-tjetri.

Pse e ke mbledhur një herë komisionin ti? E ke mbledhur me shumë të drejtë se ke ushtruar kompetencën dhe keni pasur edhe një debat. Përse nuk e mbledh, sepse e quan komisionin të këtyre? Jo, ai është komision i parlamentit.

Të lutem!

Jo, ai nuk është komisioni i këtyre, por është komision i parlamentit për atë çështje.

Do të flasim për dinjitet të parlamentit dhe për zbatim të Rregullores? Ti ke maxhorancën. E thërrisje komisionin, e quaje të mbyllur ose të bëje kërkesën për ta shtuar afatin, që ta gjykonim në Konferencën e Kryetarëve ose në seancën e Kuvendit se si do të veprohej.

Prandaj, ju lutem shumë, nëse do të flasim për dinjitet dhe ia kemi ulur dinjitetin këtij parlamenti, është praktika dhe precedentët me komisionet hetimore, që kemi ngritur në këta 28 vjet dhe nuk kemi dhënë atë produkt që duhej për të thënë edhe publiku që u ngrit një komision hetimor (nuk e kam fjalën për këtë komision, por e kam fjalën historikisht edhe kur ka qenë pala tjetër në opozitë) për të nxjerrë një konkluzion ashtu siç duhet dhe për t'ia rritur vërtet dinjitetin parlamentit dhe për të thënë që vërtet Kuvendi, në këtë republikë parlamentare ushtron kompetencën e tij kushtetuese, një nga 4 shtyllat që ka parlamentarizmi, që është kontrolli i parlamentit.

Përtej, kësaj ne nuk mund ta shkelim procedurën dhe nuk mund të krijojmë një precedent të ri. Unë jam dakord me atë që thanë zoti Balla dhe zoti Spaho, që pavarësisht nga pikëpamja formale që shtojmë afatin apo ripërsërisim me një vendim enkas, mendoj se nuk ka arsye që të krijojnë një precedent të ri. Le të përsëritet kërkesa e zotit Spaho, me të njëjtin objekt, me të njëjtin projektvendim dhe ta kalojmë në seancë për ta miratuar.

Dakord?

Edi Paloka – E vlerësoj, zoti Ruçi, kërkesën që i drejtuat Elisës për të qenë më e kujdesshme në marrëdhëniet e qeverisë me parlamentin. Jam i bindur që Elisa do ta zbatojë. Sa i përket vërejtjeve ndaj gabimeve të opozitës, opozita e zgjedh vetë se cilat instrumente do të përdorë në betejën e saj, interpelanca, mocione me debat e të tjera...

Gramoz Ruçi – Nuk e kisha për opozitën unë.

Edi Paloka – Meqë thatë keni pasur mundësi me interpelancë dhe nuk e keni shfrytëzuar, ajo ishte ideja...

Gramoz Ruçi – Jo, jo, e thashë për të gjithë. E thashë për parlamentin, jo për opozitën.

Edi Paloka – Ne shfrytëzojmë instrumentet që duam ne.

Sa për pikën tjetër, që ne jemi prapë fajtorë se nuk paskemi qenë në parlament, nuk di të ketë ndonjë kushtëzim të zbatimit të ligjit nga institucionet...

Gramoz Ruçi – Po nuk thashë këtë, thashë se jeni sovran në qëndrimet tuaja. Me vjen keq! Mos më interpreto mua! Unë thashë se ju kishit një qëndrim të kushtëzuar me institucionin e parlamentit. Është e drejta juaj.

Edi Paloka – Po e the në një mënyrë, sikur fakti që ne nuk ishim në parlament kishte kushtëzuar edhe zbatimin e ligjit në institucionet. Nuk mund të kushtëzohen institucionet dhe zbatimi i ligjit nga prania apo jo e opozitës në parlament.

Gramoz Ruçi – Thashë të kundërtën, Paloka. Unë kritikova atë. Jeta e komisionit vazhdon, pavarësisht se nuk jeni ju.

Edi Paloka – Për sa i përket shtyrjes apo ringritjes së komisionit unë mendoj që shtyrja e afatit kursen edhe kohë...

Gramoz Ruçi – Jo nuk ka nevojë fare për t'u mbledhur. Bëjeni gati dhe paraqiteni në seancë dhe menjëherë të miratohet.

Bëjeni menjëherë dhe e quajmë të ezauruan në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.

Edi Paloka – Me shpresën që Elisa këtë herë do të zbatojë porosinë tuaj dhe jo të Edi Ramës...

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zonja Vokshi!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Kryetar!

Më vjen mirë për qëndrimin tuaj kundrejt funksionit të monitorimit. Besoj se e keni seriozisht dhe shpresoj shumë që edhe kolegët e tjerë të maxhorancës të kenë që sot e tutje të njëjtin qëndrim.

Unë dua të ngre tri çështje, dy kanë të bëjnë me funksionin e monitorimit, që ju sapo përmendët. Sot, në komisionin që unë drejtoj ka ndodhur një akt tjetër shumë i rëndë. Kemi pasur në rendin e ditës diskutimin në parim të amendimeve të LSI-së për ligjin e arsimit të lartë dhe më tej dëgjese me ministren e Arsimit.

Për të akomoduar kërkesën e ministres se në orën 11:00 kishte mbledhje qeverie, e bëmë në orën 9:00.

Ministrja është larguar, ka braktisur komisionin pa iu përgjigjur asnjë pyetjeje të deputetëve të opozitës. Është larguar në mënyrë arrogante, as ka marrë leje, as ka thënë kur do të kthehet, as kur do të japë përgjigje, thjesht është larguar bashkë me stafin saj, pa lënë askënd, minimalisht, që t'u përgjigjej pyetjeve të deputetëve.

Kjo, në vijim të refuzimit të ardhjes në komision nga ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, dje e kemi kërkuar në një seancë urgjente për dhunën nda studentëve brenda ambienteve universitare. Nuk ka denjuar të vijë ministri dhe kjo në vijim edhe të refuzimit të ish-ministreve të tjera, Nikolla dhe Kumbaro, të cilave unë u jam drejtuar edhe zyrtarisht me shkrese. Ata kanë refuzuar në mënyrë të vijueshme.

Nëse ministrat refuzojnë në mënyrë të vijueshme, çdo ditë, që ne të kryejmë njërin prej funksioneve që kemi, atë të monitorimit, mbikëqyrjes së ekzekutivit, atëherë si mundet neve ta ekzekutojmë një funksion të tillë. Janë veprime në shkelje të Kushtetutës, meqenëse ju e përmendët, janë në shkelje të Rregullores së Kuvendit, meqenëse edhe ju e përmendët dhe unë do të kërkoja nga ju që të merrni masa, brenda funksionit tuaj si kryetar, që të ketë mbarëvajtje të punimeve të komisioneve. Nuk ka të bëjë fare nëse jemi deputetë të maxhorancës apo të opozitës në komision, pyetjet janë edhe për ne, edhe për ata. Nuk duhet të kemi ndarje, të paktën, në dëgjesat që kanë të bëjnë me çështje shumë më të rëndësishme, siç është problematika e studentëve sot.

Në orën 13:00 ne kemi thirrur prapë ministren që të vazhdojmë dëgjesën që ajo e braktisi. Unë do të kërkoja të merren masa që ministrja të jetë prezentë për të vijuar dëgjesën e lënë përgjysmë dhe të braktisur prej saj. Është akt i turpshëm. Si mund të vihet dinjiteti i parlamentit kur deputetët trajtohen pa respekt, pa dinjitet?

2. Kam dërguar me dhjetëra shkresa, personalisht si deputete, në kuadër të të drejtës që më jep ligji “Për statusin e deputetit” dhe unë nuk kam marrë përgjigje nga disa institucione

të ndryshme shtetërore. Me këtë rast dua ta ngre edhe një herë këtë, se ata e kanë shkelur detyrimin kushtetues duke mos kthyer përgjigje brenda 15 ditëve.

Ka shkresa që janë atje prejdisa muajsh, në disa institucione si Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Fondi i Sigurimit... pra, janë disa institucione dhe janë dhjetëra shkresa pa përgjigje.

3. Në Komisionin e Ekonomisë, ditën e hënë, është diskutuar (në fakt, është edhe gabimi im ky) amendimi i LSI-së për rritjen e buxhetit të arsimit. Ne do të kërkonim të vinte edhe në komisionin tonë. Duhej ta kisha kërkuar kur është diskutuar kalendari para një jave, por, brenda mundësive, meqenëse është çështje shumë e rëndësishme pjesa e buxhetit, do të donim të vinte për shqyrtim edhe në komisionin tonë. Këtë e kam kërkesë edhe nga deputetët e tjerë. Kjo është parashtruar edhe në mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë.

Taulant Balla – Situata në komisionin që drejton zonja Vokshi është atipike, ndodh vetëm në atë komision. Opozita drejton disa komisione.

Zonja Vokshi, më gjeni nenin në Rregullore ku i kërkohet ministres sonte në orën 8 të darkës, nesër në orën 10 të mëngjesit, të jetë në Kuvend! Të lutem!

Roli monitorues i Kuvendit ka disa instrumente shumë më të rëndësishëm se sa gallata në komisione, janë interpelancat, janë seancat e pyetjeve. Ligjvënësi, kur ka miratuar Rregulloren e Kuvendit, ka përcaktuar edhe kohën që ka në dispozicion i ftuari për t'u përgatitur.

Në rastin e interpelancave urgjente është lënë afati, brenda një jave. Në rastin e interpelancave normale, janë lënë...

(Diskutime pa mikrofon)

E ke të vështirë ta kuptosh. Neni 36 ka deficiencën. Nuk ka të përcaktuar afate, siç ka të përcaktuar interpelancat. Neni 36 është një nen pa afate dhe ti krijon situata anormale, zonjë, bën seanca dëgjimore brenda 12 orëve, brenda 24 orëve. Më thoni se në cilin parlament të botës komisioni parlamentar i çon letër sonte dhe nesër në mëngjes i thotë ministrit Lleshaj anulohet vizitën në Kosovë se të ka thirrur Albana Vokshi.

Unë të falënderoj që e hape këtë diskutim! Meqë jemi këtu, bujrum, hajde te Komisioni i Ligjeve ta rregullojmë nenin 36 dhe të vendosim afate, por afatet duhet të kenë kohë për t'u përgatitur ata që thirren dhe për t'u përgatitur edhe ata që marrin pjesë në komision, anëtarët e komisionit. Në të gjitha komisionet funksionon, këshilltari i komisionit lidhet me Shërbimin e Seancave, së bashku me Shërbimin e Seancave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pse e tund kokën sikur je...

...lidhet me kabinetet e ministrave dhe gjithmonë në këta 27 vjet është rënë dakord për datën, për orën dhe për prezantimin e ministrit. Vetëm te komisioni që drejton ti është krijuar ky problem. Nuk është ky problem në asnjë komision tjetër.

Albana, unë e di si e siguron ti vendin në grupin parlamentar, por nuk sigurohet kështu.

Faleminderit!

Edmond Spaho - Në fakt, këtu kemi një problem të madh, që është në vazhdim të asaj që diskutuam për ngritjen e komisionit hetimor, mungesën e dhënies së informacionit. Rastet që referoi zonja Vokshi janë shenjë e qartë se u shkruhet institucioneve dhe ato nuk kthejnë përgjigje. Të përgjigjen qoftë edhe duke thënë: nuk kemi informacion për këtë që kërkon ju. Kjo duhet të jetë një shenjë për ju që të reagoni, aq më tepër që zoti Ruçi e pranoi njëfarë përgjegjësie dhe kërkoi që parlamenti të ketë dinjitet. Është e vërtetë që ministrat duan kohë kur i kërkon, ka raste që sot për nesër të mos jetë e mundur të vijnë për shkak të axhendave të tyre, ashtu sikurse ka raste që ngjarja duhet të përputhet në kohë me reagimin e deputetëve. Kjo është një çështje bashkëbisedimi mes palëve dhe të gjendet rruga e mundshme. Nuk ka kuptim të bëjmë një seancë dëgjimore me ministrin kur ngjarja ka humbur jo lajmin, por efektin e saj, nuk është më në qendër, se ka dalë një çështje tjetër, sepse këtu prodhohet përditë ndonjë lajm për maxhorancën.

Rasti i sotëm nuk bën fjalë për mungesë kohe, për të planifikuar ardhjen, sepse zonja ministre e Arsimit erdhi në Kuvend, madje u akomodua në kohë, meqenëse kishte mbledhjen e qeverisë në orën 11:00, komisioni e toleroi dhe filloi punën që në orën 09:00, por sapo erdhi nuk priti të marrë pyetjet, reagoi me ashpërsi dhe iku. Kjo tregon mungesë respekti ndaj Kuvendit dhe komisionit. Të jeni të sigurt se edhe pasi të mbarojë mbledhja e qeverisë, edhe në orën 13:00, pavarësisht shikimeve qesëndisëse të zonjës, ministrja nuk ka për të ardhur. Ju pëlqejnë apo jo këto, por ministrja nuk ka për të ardhur më. Kjo është shqetësuese, nëse ju përgjigjeni me ironi dhe me të qeshura simpatike si këto që bën Ulsi, dakord, por nuk mendoj se kjo është rruga e reagimit të maxhorancës, kur ngremë një çështje shumë të rëndësishme për ne si opozitë, nëse doni marrëdhënie me ne që të funksionojë parlamenti. Nëse nuk na doni në parlament, silluni kështu siç po silleni dhe ne do të gjejmë rrugë të tjera, do të gjejmë mundësinë për të realizuar atë rol që ka opozita.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi - Nëse Taulanti thotë se ne bëjmë gallatë në komisione, atëherë nuk mund të vihet dinjiteti që ju folët. Raportimi në komision është shumë i rëndësishëm.

Më vjen keq, nuk jeni të paktën në një linjë.

Genc Pollo – Faleminderit, Kryetar, që na jepni edhe neve këtë nga fundi fjalën!

Unë dua të ngre një çështje që lidhet me Komisionin e Integritit European. Rregullorja e Kuvendit dhe ligji e detyrojnë që të gjitha projektligjet që prekin çështjet e *acquis* të shqyrtohen në këtë komision. Në fillimin e legjislaturës e kam ngritur në Konferencën e Kryetarëve faktin që disa nisma ligjore të deputetëve që prekin *acquis* nuk janë shqyrtuar. Mbaj mend se ju i dhatë porosi stafit që çdo nismë e tillë të shqyrtohej edhe nga Komisioni i Integritit. Me sa kam vënë re nuk është përsëritur më ky problem. Në mbledhjen e fundit që bëmë, të parën dhe të fundit që kemi bërë këtë vit, ditën e hënë u ngrit besoj me të drejtë shqetësimi për dy ligje, që kanë kaluar me procedurë të përshpejtuar, që prekin Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Të dyja projektligjet, ligjet pastaj janë bërë objekt debati, letërkëmbimi, dialogu me Komisionin European, e kam fjalën për ligjin “Fusha” për teatrin, i cili në një farë mënyre u trajtua.

Ligji tjetër është për aeroportin e Vlorës dhe ka përsëri një komunikim me Komisionin European, me sa kam lexuar ka edhe shqetësime nga vendet anëtare. Është një ligj që nuk u shqyrtua fatkeqësisht nga Komisioni i Integritit European për të verifikuar nëse është në përputhje me MSA-në dhe me *acquis* apo jo. U ngrit shqetësimi edhe për një projektligj që mendohet se e shkel atë, për korporatën e investimeve shqiptare, që kur të vijë duhet të jemi vigjilentë, administrata ta ketë parasysh dhe ta fusë në kalendar për komisionin tonë për dhënie mendimi.

Kërkesa që kam unë, e para duhet të kujdesemi të respektojmë ligjshmërinë dhe traktatet.

E dyta, jemi të ndërgjegjshëm për pasojat negative që mund të ketë për vendimmarrjen europiane. Një ligj ku dyshohet shkelja e traktatit duhet një zgjidhje për të shqyrtuar nga komisioni ynë ligjin për aeroportin e Vlorës të miratuar në shkurt të vitit të kaluar me procedurë të përshpejtuar nga Kuvendi, në mënyrë që ne të gjejmë, të shprehemi për përputhshmërinë e tij me MSA-në dhe me *acquis* europiane. Kjo është çështja. Ne nuk kemi marrë një vendim, por kjo do të ngrihet në mbledhjen e ardhshme ndoshta me konsensus, sepse në komision kemi frymë bashkëpunimi, ndoshta me nismë deputetësh do t’ju drejtohem për të gjetur një zgjidhje administrative brenda që të shqyrtohet. Është situatë e pazakonshme, sepse e di që ligji ka hyrë në fuqi, prandaj po e ngre si shqetësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e thashë është miratuar në muajin shkurt, por ka shqetësime se shkel MSA-në dhe ne do të donim që ta shqyrtonim si komision për të reaguar më pas mbi atë ligj, për të bërë

korrigjimet, nëse e gjykojmë se ka nevojë. Kjo është kërkesa. Problemi është politik sa dhe ligjor dhe mund të gjenden rrugëzgjdhje nëse ka vullnet të mirë.

Gramoz Ruçi - Në parim, në lidhje me kërkesën që shtron kryetari Komisionit të Integritetit, ju të stafit, kijeni parasysh që çfarë projektligjesh kanë lidhje me MSA-në, sigurisht që duhet të kalojnë në atë komision.

Unë do t'ju lutesha që edhe ju vetë të jeni këtu prezent kur shikoni qoftë programin dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit, prandaj zhvillohet Konferenca e Kryetarëve, prandaj zhvillohet seanca që të shtrohen argumentet përkatëse për këtë çështje, se cila të përfshihet në komision dhe çfarë duhet të bëjë.

E dyta, zonja Spiropali, për pjesëmarrjen e përfaqësisë së ministrave në mbledhje e kemi biseduar edhe individualisht, kemi marrë porosi edhe nga Kryeministri, programi i punës së komisioneve miratohet këtu, miratohet edhe në seancë, pra, aty janë të caktuara edhe datat e komisionit. Nuk është përgjegjësi e komisioneve të parlamentit nëse ministria nuk është prezente në atë datë kur diskutohet ligji. Në këtë aspekt, ka të drejtë, po e diskutoj në parim për të gjitha mbledhjet e komisioneve pa përjashtim.

E dyta, për thirrjen e ministrave, ju lutem shumë, unë e kuptoj se secili grupim politik mund të bëjë lëvizjet politike, njëri apo tjetri, por kur je në drejtimin e komisionit nuk mund të kërkohet asnjë ministër sot për nesër. Edhe kur e thërrasim në interpelancë apo në seancë pyetjesh kërkon minimumi 3 javë kohë. Prandaj keni këshilltarët, vendoset me kërkesë apo me vendim të komisionit përkatës, këshilltari përkatës apo administrata përkatëse me qeverinë, merren vesh me ministrin, caktohet data, rakordohet. Kështu është precedenti parlamentar historikisht në këta 29 vjet që kam unë, vendoset data se kur do të vijë ministri në komision dhe ora për të folur, nëse duam të bëjmë punë, nëse duam të bëjmë spektakël, sigurisht është e drejta e secilit.

Mirë këtu e mbyllim mbledhjen

Mirë u pafshim!

MBYLLET MBLEDHJA